



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 30 shtator 2010, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Gani Geci, Bajram Kosumi, Selville Halimi, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Kolë Berisha, Adem Hajdaraj, Radmila Vujović dhe Mufera Şinik.

Munguan:– Bahri Hyseni - ishte në udhëtim zyrtar dhe Ibrahim Makolli.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Gani Geci, nënkryetar i parë i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesor për Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe për Projektligjin për prokurorin e shtetit dhe
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi propozoi, për shkak të vazhdimit të punimeve në mbledhjen plenare, pika e dytë e rendit të ditës të shqyrtohet në pushimin e mbledhjes plenare.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe për projektligjin për prokurorin e shtetit

Kryesuesi - Theksoi se për shkak të nevojave të përsheptimit të procedimit të këtyre projektligjeve ishte e nevojshme të mbahej kjo mbledhje, edhe pse nuk ishte planifikuar të mbahet sot. Në këtë mbledhje do t'i shqyrtojmë raportet e komisioneve kryesore për këto projektligje. Kërkoj nga anëtarët e Komisionit t'i paraqesin vërejtjet eventuale për këto raporte.

Komisioni i shqyrtoi raportet e komisioneve kryesore dhe vlerësoi se projektligjet e theksuara dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni nuk kishin implikime buxhetore, janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, nuk i cenojnë interesat e komuniteteve dhe nuk i cenojnë të drejtat e njeriut.

Meqë nuk kishte vërejtje nga komisionet kryesore, kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

R E K O M A N D I M

Të miratohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës projektligjet e theksuara me amendamentet e propozuara.

Pjesa e parë e mbledhjes përfundoi në orën 10:05 dhe vazhdoi me pikën e dytë të rendit të ditës në orën 11:00.

Në pjesën e dytë të mbledhjes ishin të pranishëm: Radmila Vujović - kryesuese, Bajram Kosumi, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha Adem Hajdaraj dhe Mufera Şinik.

Mungoi: Gani Geci

Në pjesën e dytë mbledhjen e kryesoi Radmila Vujović – nënkryetar i dytë i Komisionit.

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës

Në këtë pikë u shqyrtua Projektligji për prokurimin publik në Republikën e Kosovës me amendamente të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL. Nga anëtarët e Komisionit nuk pati vërejtje në Projektligj as në amendamentet e propozuara dhe u konstatua se Projektligji me amendamente e kanë bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Komisioni rekomandoi që Projektligji me amendamente të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni